L I G J
Nr.8525, datë 9.9.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS EUROPIANE PËR TELEVIZIONIN NDËRKUFITAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Europiane për Televizionin Ndërkufitar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2447, datë 9.9.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA EUROPIANE PËR TELEVIZIONIN NDËRKUFITAR

Strasburg 5.5.1999
Seria e traktateve europiane nr.132

H Y R J E

Shtetet anëtare te Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera palë në Konventën Kulutore Europiane, veç kësaj nënshkruese;

Duke marrë në konsideratë që qëllimi i Këshillit të Europës është që të arrijë një unitet më të madh midis anëtarëve të tij, me qëllim që të ruajë dhe të realizojë idealet dhe parimet që janë pasuria e tyre e përbashkët;

Duke marrë në konsideratë se dinjiteti dhe vlera e barabartë e çdo qenieje njerëzore përbëjnë elementet themelore të këtyre parimeve;

Duke marrë në konsideratë se liria e shprehjes dhe e informimit, siç përfshihet në nenin 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore, përbën një nga parimet themelore të një shoqerie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo qenieje njerëzore;

Duke riafirmuar zotimin e tyre për parimet e rrjedhjes së lirë të informacionit dhe ideve dhe për pavarësinë e transmetuesve radiofonikë dhe televizivë, që përbëjnë një bazë të domosdoshme për politikën e tyre të transmetimit;

Duke afirmuar rëndësinë e transmetimit për zhvillimin e kulturës dhe për formimin e lirë të opinioneve në kushtet e ruajtjes së pluralizmit dhe të mundësive të barabarta midis gjithë grupeve demokratike dhe partive politike;

Të bindur se zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duhet të shërbejë për të çuar më tej të drejtën, pavarësisht nga kufijtë, për të shprehur, për të kërkuar, për të marrë dhe për të njoftuar informacion dhe ide çfarëdo qoftë burimi i tyre;

Duke patur dëshirë të paraqesin një fushë në rritje zgjedhjesh për shërbime programesh për publikun, duke nxitur trashëgiminë e Europës dhe duke zhvilluar krijimtarinë e saj autovizuale dhe duke qenë të vendosur ta arrijnë këtë objektiv kulturor nëpërmjet përpjekjeve për të rritur prodhimin dhe qarkullimin e programeve me cilësi të lartë, duke iu përgjigjur kështu asaj çka pret publiku në fushën politike, edukative dhe kulturore;

Duke njohur nevojën për të konsoliduar kuadrin e gjerë të përbashkët te Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera palë, duke mbajtur në mendje Rezolutën nr.2 dhe Deklaratën e Konferencës së parë Ministrore Europiane mbi politikën e Masmedias;

Duke patur dëshirë të zhvillojnë parimet e përfshira në rekomandimet ekzistuese të Këshillit të Europës mbi parimet, mbi reklamat televizive, mbi barazinë midis grave dhe burrave në media, në përdorimin e kapaciteteve satelitore për televizionin dhe radion dhe mbi promovimin e prodhimit audioviziv në Europë;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Kjo Konventë merret me shërbimet e programeve të përfshira në transmetime. Qëllimi është të lehtësojë midis palëve transmetimet ndërkombëtare dhe ritransmetimin e shërbimeve programore televizive.

Neni 2
Termat e përdorura

Për qëllimet e kësaj konvente:

a) “Transmetim” do të thotë përhapja fillestare me transmetues tokësor, me kabëll ose me satelit të çdo lloj natyre me formë të koduar apo të pakoduar të shërbimeve programore televizive, që i drejtohen publikut në përgjithësi. Ky nuk përfshin shërbimet e komunikimit që veprojnë mbi kërkesat individuale.

b) “Ritransmetim” do të thotë fakti i marrjes dhe i transmetimit në të njejtën kohë, pavarësisht nga mjetet teknike të përdorura, i shërbimeve programore, televizive të plota dhe të pandryshuara, ose i pjesëve të rëndësishme të shërbimeve të tilla, të transmetuara nga radiotelevizione, që i drejtohen publikut në përgjithësi.

c) “Radiotelevizion” do të thotë person fizik ose juridik që përgatit shërbime programore televizive që i drejtohen publikut të gjerë dhe i transmeton ato ose i bën të transmetohen të plota dhe të pandryshara nga një pale e tretë.

d) “Shërbim programor” do të thotë të gjitha zërat brenda një shërbimi të vetëm të siguruar nga një radiotelevizion i dhënë, brenda kuptimit të paragrafit të mësipërm.

e) “Vepra audiovizive europiane” do të thotë vepra krijuese, prodhimi ose bashkëprodhimi i të cilave kontrollohet nga persona fizikë ose juridik europianë.

f) "Reklamë” do të thotë çdo njoftim publik që ka qëllim të nxisë shitjen blerjen ose marrjen/dhënien me qera të një shërbimi programor, për të çuar përpara një çështje ose ide ose për të shkaktuar një efekt të dëshiruar nga reklamuesi, për të cilën reklamuesit i është dhënë kohë transmetimi me shpërblim ose konsiderata të ngjashme.

g) “Sponsorizim” do të thotë pjesëmarrja e një personi fizik ose juridik, i cili nuk është i

përfshirë në veprimtari radiotelevizive ose në prodhimin e veprave audiovizive, në financimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të një programi, me qëllim që të promovohet emri, marka ose imazhi i atij personi.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo konventë do të zbatohet për çdo shërbim programor të transmetuar ose të ritransmetuar nga entitete ose me mjete teknike brenda juridiksionit të një pale, me kabëll, transmetues tokësor ose satelit dhe që mund të merret, drejtpërsëdrejti ose jo, në një ose më shumë palë të tjera.

Neni 4
Liria e marrjes dhe ritransmetimit

Palët do të sigurojnë lirinë e shprehjes dhe formimit në përputhje me nenin 10 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore dhe ato do të garantojnë lirinë e marrjes dhe nuk do të kufizojnë ritransmetimin në territorin e tyre të shërbimeve programore që përputhen me termat e kësaj konvente.

Neni 5
Detyrat e palëve transmetuese

Çdo palë transmetuese do të sigurojë me anë të mjeteve të përshtatshme dhe nëpërmjet organeve të saj kompetente, që të gjitha shërbimet programore të transmetuara nga antitete ose me anë të mjeteve teknike brenda juridiksionit të saj, sipas kuptimit të nenit 3, të përputhen me termat e kësaj Konvente.

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, pala transmetuese do të jetë:

a) në rastin e transmetimeve tokësore, pala në të cilën është kryer përhapja fillestare;

b) në rastin e transmetimeve satelitore:

i) pala në të cilën është vendosur pajisja satelitore up-link;

ii) pala e cila lejon përdorimin e një frekuence ose të një kapaciteti satelitor kur pajisja up-link është e vendosur në një shtet, i cili nuk është palë në këtë Konventë;

iii) pala ku radiotelevizioni ka qendrën e vet, kur nuk përcaktohet përgjegjësia sipas nënparagrafeve i dhe ii.

3. Kur shërbimet programore të transmetuara nga shtete që nuk janë palë të kësaj konvente ritransmetohen nga entitete ose me anë të mjeteve teknike brenda juridiksionit të një pale, sipas kuptimit të nenit 3, kjo palë që vepron si pala transmetuese, do të sigurojë, me anë të mjeteve të përshtatshme dhe nëpërmjet organeve të saj kompetente, përputhjen me termat e kësaj konvente.

Neni 6
Kushte të informacionit

1. Përgjegjësitë e radiotelevizonit do të specifikohen qartë dhe në mënyrë të përshtatshme në autorizimin e lëshuar nga, ose ne kontratën e nënshkruar me autoritetin kompetent të çdo pale ose me anë të çdo mase tjetër ligjore.

2. Informacioni mbi radiotelevizionin do të vihet në dispozicion me kërkesë nga autoriteti kompetent i palës transmetuese. Një informacion i tillë do të përfshijë si minimum emrin ose emërtimin, qendrën dhe statusin e radiotelevizionit, emrin e përfaqësuesit ligjor, përbërjen e kapitalit, natyrën, qëllimin dhe mënyrën e financimit të shërbimit programor që radiotelevizioni

siguron apo ka si qëllim të sigurojë.

KREU II
ÇËSHTJET E PROGRAMIMIT

Neni 7
Përgjegjësitë e radiotelevizionit

1. Të gjithë përbërësit e shërbimeve programore, lidhur me shfaqjen apo përbërjen e tyre, do të respektojnë dinjitetin e qenieve njerëzore dhe të drejtat themelore të të tjerëve.

Në veçanti ato:

a. nuk do të jenë të paturpshme dhe në veçanti nuk do të përmbajnë pornografi;

b. nuk do t'i japin theks të paarsyeshëm dhunës ose të kenë gjasa te nxisin urrjetjen raciale.

2. Të gjitha shërbimet programore, të cilat ka gjasa të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve dhe adoleshentëve, nuk do të vihen në program kur, për shkak të kohës së transmetimit dhe të marrjes, ka gjasa që ata t'i shohin ato.

3. Radiotelevizioni do të sigurojë që lajmet të paraqesin faktet dhe ngjarjet ndershmërisht dhe të inkurajojnë formimin e lirë të opinioneve.

Neni 8
E drejta për t'u përgjigjur

1. Çdo palë transmetuese do të sigurojë që çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nga kombësia apo vendi i rezidencës, të ketë mundësi të ushtrojë të drejtën e përgjigjes ose të kërkojë mjete të tjera të krahasueshme ligjore apo administrative lidhur me programe të transmetuara ose ritransmetuara nga entitete apo me mjete teknike brenda juridiksionit të saj, sipas kuptimit të nenit 3. Në veçanti, ajo do të sigurojë që koha dhe organizimet e tjera për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes të jenë të tilla që kjo e drejtë të mund të ushtrohet me efektivitet. Ushtrimi me efektivitet i kësaj të drejte apo i mjeteve të tjera të krahasueshme ligjore ose administrative do të sigurohet si në lidhje me kohën, ashtu edhe me modalitetet.

2. Për këtë qëllim, emri i radiotelevizionit përgjegjës për shërbimin programor do të identifikohet në intervale të rregullta me anë të mjeteve të përshtatshme.

Neni 9
Njohja e publikut me ngjarjet e mëdha

Çdo palë do të shqyrtojë masat ligjore për të shmangur dëmtimin e së drejtës së publikut për informim për shkak të ushtrimit nga një radiotelevizion i të drejtave ekskluzive për transmetim apo ritranssmetim, sipas kuptimit të nenit 3, për një ngjarje me interes të madh publik dhe që ka si pasojë të privojë një pjesë të madhe të publikut në një ose më shumë palë të tjera nga mundësia për ta ndjekur atë ngjarje në televizion.

Neni 10
Objektiva kulturorë

1. Çdo palë transmetuese do të sigurojë, kur zbatohet dhe me anë të mjeteve të përshtatshme, që radiotelevizionet t'i rezervojnë veprave europiane një pjesë më të madhe të kohës së tyre të transmetimit, duke mos përfshirë këtu kohën e caktuar të lajmeve, ngjarjeve sportive, lojrave, reklamave dhe shërbimeve të teletekstit. Kjo pjesë, duke mbajtur parasysh përgjegjësitë informative, edukative, kulturore dhe argëtuese të radiotelevizionit para publikut që

e ndjek atë, do të arrihet në mënyrë progresive mbi bazën e kritereve të përshtatshme.

2. Në rast mosmarrëveshjeje midis një pale marrëse dhe një pale transmetuese, në zbatimin e paragrafit të mësipërm, mund t'i drejtohen, me kërkesën e njerës palë, Komitetit të Perhershëm me qëllim që të formulojë një opinion të kundërt mbi subjektin. Një mosmarrëveshje e tillë nuk do t'i nënshtrohet procedurës së arbitrimit që parashikohet në nenin 26.

3. Palët marrin përsipër të kërkojnë së bashku instrumentet dhe procedurat më të përshtatshme për të mbështetur pa diskriminim, midis radiotelevizioneve, veprimtarinë dhe zhvillimin e prodhimit europian, veçanërisht në vendet me një kapacitet të ulët prodhimi audiovizual ose në një zonë të ngushtë gjuhësore.

Palët, me shpirtin e bashkëpunimit dhe asistencës reciproke që shtrihet në këtë Konventë, do të përpiqen të shmangin që shërbimet programore të transmetuara ose ritransmetuara nga entitete ose me mjete teknike brenda juridiksionit të tyre, sipas kuptimit të nenit 3, të rrezikojnë pluralizmin e shtypit dhe zhvillimin e industrisë kinematografike. Në përputhje me këtë, nuk do të transmetohen vepra kinematografike në shërbime të tilla, me përjashtim të rastit kur është bërë marrëveshje e ndryshme midis pronarit të të drejtave dhe transmetuesit, pa kaluar dy vjet nga koha kur vepra është shfaqur për herë të parë në kinema, në rastet e veprave kinematografike të bashkëprodhuara nga radiotelevizioni, kjo periudhë do të jetë një vit.

KREU III
REKLAMAT

Neni 11
Standarde të përgjithshme

1. Gjithë reklamat do të jenë të drejta dhe të ndershme.

2. Reklamat nuk do të jenë çorientuese dhe nuk do të paragjykojnë interesat e konsumatorëve.

3. Reklamat drejtuar fëmijëve apo që i përdorin ata do të shmangin gjithçka që ka gjasa të dëmtojë interesin e tyre dhe do të mbajnë parasysh ndjeshmërinë e tyre të veçantë.

4. Ai që bën reklamën nuk do të ushtrojë ndonjë ndikim redaktues mbi përmbajtjen e programeve.

Neni 12
Kohëzgjatja

1. Sasia e reklamave nuk do të kapërcejë 15 për qind të kohës ditore të transmetimit. Megjithatë, kjo përqindje mund të rritet deri në 20 për qind dhe të përfshihen këtu forma reklame të tilla si oferta direkte për shitje, blerje apo dhënie me qera të produkteve drejtuar publikut, ose për të siguruar shërbime, me kusht që sasia e spoteve të reklamave të mos kalojë 15 per qind.

2. Sasia e spoteve të reklamave brenda një periudhe të dhënë një orëshe nuk do të kapërcejë 20 për qind.

3. Forma reklame të tilla si oferta direkte për shitje, blerje apo dhënie me qera të produkteve drejtuar publikut, ose për të siguruar shërbime nuk do të kapërcejnë një orë në ditë.

Neni 13
Forma dhe paraqitja

1. Reklamat do të dallohen qartë si të tilla dhe do të ndahen dukshëm nga pjesët e tjera të shërbimit programor me anë të mjeteve optike ose akustike. Në parim, ato do të transmetohen në blloqe.

2. Reklamat subkoshiente nuk do të lejohen.

3. Reklamat e fshehta nuk do të lejohen, në veçanti paraqitja e produkteve ose shërbimeve në programe kur i shërben qëllimeve të reklamave.

4. Reklamat nuk do të shfaqin, në mënyrë vizuale apo orale, persona që paraqesin rregullisht programet e lajmeve apo të çështjeve të ditës.

Neni 14

Vendosja e reklamave

1. Reklamat do të vendosen midis programeve. Me kusht që të plotësohen kushtet që përmbahen në paragrafin 2 deri në 5 të këtij neni, reklamat mund të vendosen edhe gjatë programeve në mënyrë të tillë që integriteti dhe vlera e programeve dhe të drejtat e zotëruesve të të drejtave të autorit të mos cenohen.

2. Në programet që përbëhen nga pjesë të pavarura ose në programe sportive dhe ngjarje apo shfaqje që kanë strukturë të ngjashme që përmban intervale, reklamat do të vendosen vetëm ndermjet pjesëve ose në intervale.

3. Transmetimi i veprave audiovizive të tilla si filma artistikë dhe filma për televizionin (duke mos përfshirë këtu seri, seriale, programe zbavitëse dhe dokumentarë), me kusht që kohëzgjatja e tyre të jetë më shumë se dyzet e pesë minuta, mund të ndërpritet një herë për çdo periudhë të plotë dyzet e pesë minutshe. Lejohet një ndërprerje e mëtejshme nëse kohëzgjatja e tyre është të paktën njëzet minuta më e gjatë se dy ose më shumë periudha të plota prej dyzet e pesë minutash.

4. Kur ndërpriten prej reklamave, programe që nuk përfshihen në paragrafin 2, duhet të kalojë një periudhë prej të paktën njëzet minutash ndërmjet dy ndërprerjeve të njëpasnjëshme për reklama brenda programit.

5. Reklamat nuk do të futen në ndonjë transmetim të shërbimeve fetare. Programet e lajmeve, të çështjeve të ditës, dokumentarët, programet fetare dhe programet e fëmijëve, kur kanë një kohëzgjatje më pak se tridhjetë minuta, nuk do të ndërpriten me reklama. Nëse ato zgjasin tridhjetë minuta ose më shumë, do të zbatohen parashikimet e paragrafit të mësipërm.

Neni 15

Reklamat e produkteve të veçanta

1. Nuk do të lejohen reklama për prodhimet e duhanit.

2. Reklamat për pijet alkoolike të të gjitha llojeve duhet të përmbushin rregullat e mëposhtme:

a. ato nuk do t’i drejtohen në veçanti minorenëve dhe askush që do të përfshihet me konsumin e pijeve alkoolike në reklama nuk duhet të ketë gjasa të jetë minoren;

b. ato nuk duhet ta lidhin konsumin e alkoolit me shfaqje fizike apo me drejtimin e automjeteve;

c. ato nuk duhet të shprehin se alkooli ka veti terapeutike apo se është stimulant, qetësues ose një mjet për të zgjidhur problemet vetjake;

d. ato nuk duhet të inkurajojnë konsumim të tepëruar të alkoolit apo të paraqesin mospërdorimin ose përdorimin me mase në një drite negative;

e. ato nuk duhet të vënë theks të papërshtatshëm në përmbajtjen alkoolike të pijeve.

3. Nuk do të lejohen reklamat për ilaçe dhe trajtime mjekësore që janë në dispozicion në palën transmetuese vetëm me recetë mjekësore.

4. Reklamat për gjithë ilaçet dhe trajtimet mjekësore të tjera do të dallohen qartë si të tilla, do të jenë të ndershme, të vërteta, do t'i nënshtrohen verifikimit dhe do të përputhen me kërkesat e mbrojtjes së individit nga dëmtimi.

Neni 16
Reklamat drejtuar veçanërisht një pale të vetme

1. Me qëllim që të shmangen shtrembërimet në konkurim dhe rrezikimi i sistemit televiziv të një pale, reklamat që i drejtohen veçanërisht dhe me një farë frekuence publikut në një palë të vetme që nuk është pala transmetuese, nuk do t'i shmangen rregullave të reklamës televizive në atë palë të veçantë.

2. Kushtet e paragrafit të mësipërm nuk do të zbatohen kur:

a. rregullat në fjalë vendosin një diskriminim ndërmjet reklamave të transmetuara nga entitete ose me anë të mjeteve teknike brenda juridiksionit të asaj pale dhe reklamave të transmetuara nga entitete ose me anë të mjeteve teknike brenda juridiksionit të asaj pale dhe reklamave të transmetuara nga entitete ose me anë të mjeteve teknike brenda juridiksionit të një pale tjetër; ose

b. palët në fjalë kanë përfunduar marrëveshjen dypalëshe ose shumëpalëshe në atë fushë.

KREU IV
SPONSORIZIMI

Neni 17
Standarde të përgjithshme

1. Kur një program apo seri programesh sponsorizohen plotësisht apo pjesërisht, do të dallohen qartë si të tillë me anë të atributeve të përshtatshme në fillim dhe/ose në fund të programit.

2. Përmbajtja dhe programimi i programeve të sponsorizuara në asnjë rrethanë nuk mund të ndikohet nga sponsori në mënyrë të tillë që të cenojë përgjegjësinë dhe pavarësinë redaksionale të radiotelevizionit në lidhje me programet.

3. Programet e sponsorizuara nuk do të nxisin shitjen, blerjen ose marrje-dhënien me qera të prodhimeve apo shërbimeve të sponsorit apo të një pale të tretë, veçanërisht duke bërë referime të veçanta promovuese atyre prodhimeve ose shërbimeve në programe të tilla.

Neni 18
Ndalimi i sponsorizimit

1. Programet nuk mund të sponsorizohen nga persona fizikë ose juridikë, veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimi ose shitja e produkteve apo sigurimi i shërbimeve, reklama e të cilëve është e ndaluar me anë të nenit 15.

2. Nuk do të lejohet sponsorizimi i programeve të lajmeve apo të çështjeve të ditës.

KREU V
ASISTENCA RECIPROKE

Neni 19
Bashkëpunimi midis palëve

1. Palët marrin përsipër t'i japin njëra-tjetrës asistencë reciproke me qëllim që të zbatohet kjo Konventë.

2. Për këtë qëllim:

a. çdo shtet kontraktues do të përcaktojë një ose më shumë autoritete, emri dhe adresa e të cilëve do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në kohën kur të depozitohet instrumenti i tij i ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes në fuqi;

b. çdo shtet kontraktues që ka përcaktuar më shumë se një autoritet do të specifikojë në komunikimin e tij sipas nënparagrafit a, kompetencat e çdo autoriteti.

3. Një autoritet i përcaktuar nga një palë:

a. do të japë informacionin e parashikuar sipas nenit 6, paragrafi 2 i kësaj Konvente;

b. do të japë informacion sipas kërkesës së një autoriteti të përcaktuar nga një palë tjetër mbi ligjin dhe praktikat e brendshme në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

c. do të bashkëpunojë me autoritetet e përcaktuara nga palët e tjera kurdoherë që të jetë e dobishme, dhe veçanërisht kur kjo gjë do të çojë përpara efektivitetin e masave të marra në zbatim të kësaj Konvente;

ç. do të marrë në konsideratë ndonjë vështirësi të dalë nga zbatimi i kësaj Konvente për të cilën ia ka tërhequr vëmendjen një autoritet i përcaktuar nga një palë tjetër.

KREU VI
KOMITETI I PËRHERSHËM

Neni 20
Komiteti i përhershëm

1. Për qëllimet e kësaj Konvente do të formohet një Komitet i Përhershëm.

2. Çdo palë mund të përfaqësohet në komitetin e përhershëm nga një ose më shumë delegatë. Çdo delegacion do të ketë një votë. Brenda fushës së kompetencës së tij, Komuniteti Ekonomik Europian do të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar me një numër votash të barabartë me numrin e shteteve të tij anëtare, të cilat janë palë në këtë Konventë; Komiteti Ekonomik Europian nuk do të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar në rastet kur shtetet anëtare të interesuara ushtrojnë të drejtën e tyre dhe anasjelltas.

3. Çdo shtet të cilit i referohet neni 29 paragrafi 1, që nuk është palë në këtë Konventë mund të përfaqësohet në Komitetin e Përhershëm me një vëzhgues.

4. Komiteti i Përhershëm mund të kërkojë këshillën e ekspertëve me qëllim që të plotësojë funksionet e tij. Ai mundet, me iniciativën e tij ose sipas kërkesës së organit përkatës, të ftojë ndonjë organ ndërkombëtar ose kombëtar, qeveritar ose joqeveritar, teknikisht të kualifikuar në fushat e mbuluara nga kjo Konventë, që të përfaqësohet nga një vëzhgues në një ose në një pjesë të një mbledhjeje të tij. Vendimi për të ftuar ekspertë ose organe të tilla do të merret me një mazhorancë prej tre të katërtash të anëtarëve të Komitetit të Përhershëm.

5. Komiteti i Përhershëm do të thirret në mbledhje nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Mbledhja e parë e tij do të mbahet brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më tej ai do të mblidhet kurdoherë që ta kërkojë një e treta e palëve ose Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës ose me iniciativën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në përputhje me parashikimet e nenit 23, paragrafi 2, ose me kërkesën e një ose më shumë palëve në përputhje me parashikimet e nenit 21, nënparagrafi c dhe 25, paragrafi 2.

6. Një mazhorancë e palëve do të përbëjë një kuorum për të mbajtur një mbledhje të Komitetit të Përhershëm.

7. Sipas parashikimeve të paragrafit 4 dhe neni 23, paragrafi 3, vendimet e Komitetit të Përhershëm do të merren nga një mazhorancë prej tre të katërtash e anëtarëve të pranishëm.

8. Sipas parashikimeve të kësaj Konvente, Komiteti i Përhershëm do të hartojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 21
Funksionet e Komitetit të Përhershëm

Komiteti i Përhershëm do të jetë përgjegjës për të ndjekur zbatimin e kësaj konvente. Ai mund:

a. t'i bëjë rekomandime palëve lidhur me zbatimin e Konventës;

b. të sugjerojë ndonjë modifikim të nevojshëm të Konventës dhe të shqyrtojë ato të propozuara në përputhje me parashikimet e nenit 23;

c. të shqyrtojë, me kërkesën e një ose më shumë palëve, çështje lidhur me interpretimin e Konventës; të përdorë përpjekjet e tij më të mira për të siguruar një zgjidhje miqësore të çdo vështirësie që i referohet atij në përputhje me parashikimet e nenit 25;

e. t'i bëjë rekomandime Komitetit të Ministrave lidhur me shtetet përveç atyre që iu referohet neni 29, paragrafi 1, që të ftohen për të hyrë në këtë Konventë.

Neni 22

Raportet e Komitetit të Përhershëm

Pas çdo mbledhjeje, Komiteti i Përhershëm do t'i paraqesë palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi diskutimet e tij dhe ndonjë vendim të marrë.

KREU VII
AMENDAMENTET

Neni 23

Amendamentet

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente për këtë Konventë.

2. Çdo propozim për amendament do t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do t'ia komunikojë atë shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve të tjera palë në Konventën Kulturore Europiane, Komunitetit Ekonomik Europian dhe çdo shteti tjetër joanëtar, i cili ka hyrë ose është ftuar të hyjë në këtë Konventë në përputhje me parashikimet e nenit 30. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të thërrasë një mbledhje të Komitetit të Përhershëm sa më shpejt dy muaj pas komunikimit të propozimit.

3. Komiteti i Përhershëm do të shqyrtojë çdo amendament të propozuar dhe do t'ia paraqesë për aprovim Komitetit të Ministrave, tekstin e adoptuar nga një mazhorancë prej tre të katërtash e anëtarëve të Komitetit të Përhershëm.

4. Çdo amendament do të hyjë në forcë ditën e tridhjetë pasi të gjitha palët të kenë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për miratimin e tij.

KREU VIII
SHKELJET E DEKLARUARA TË KËSAJ KONVENTE

Neni 24

Shkeljet e deklaruara të kësaj Konvente

1. Kur një Palë gjen një shkelje të kësaj Konvente, ajo do t'i komunikojë Palës transmetuese shkeljen e dëshmuar dhe të dy Palët do tëpërpiqen të kapërcejnë vështirësitë në bazë të parashikimeve të neneve 19, 25 dhe 26.

2. Në se shkelja e dëshmuar ka një natyrë të shfaqur, serioze dhe të rëndë e cila ngre çështje publike të rëndësishme dhe përfshin nenin 7, paragrafi 1 ose 2, 12, 13, paragrafi 1 fjalia e parë, 14 ose 15 paragrafët 1 ose 3, dhe nëse vazhdon brenda dy javëve pas komunikimit, pala marrëse mund të pezullojë përkohësisht transmetimin e shërbimit programor nën akuzë.

3. Në të gjitha rastet e shkeljes së dëshmuar, me përjashtim të atyre të parashikuara në paragrafin 4, pala marrëse mund të pezullojë përkohësisht ritransmetimin e shërbimit programor nën akuzë, tetë muaj pas komunikimit, nëse shkelja e dëshmuar vazhdon.

4. Pezullimi i përkohshëm i ritransmetimit nuk do të lejohet në rastin e shkeljeve të

dëshmuara të nenit 7 paragrafi 3 dhe neneve 8, 9 ose 10.

KREU IX
ZGJIDHJA E POLEMIKAVE

Neni 25
Pajtimi

1. Në rast vështirësie që del nga zbatimi i kësja Konvente, palët në fjalë do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje miqësore.

2. Nëse njëra nga palët përkatëse kundërshton, komiteti i mbledhur mund ta shqyrtojë çështjen duke vendosur veten në dispozitën e palës përkatëse në mënyrë që të arrijë një zgjidhje të kënaqshme sa më shpejt që të jetë e mundur dhe ku ka mundësi të formulojë një opinion këshillues mbi çështjen.

3. Secila nga palët përkatëse zotohet që t'i akordojë komitetit të mbledhur pa vonesë të gjithë informacionin dhe lehtësitë e nevojshme për t'u liruar nga funksionet sipas paragrafit pararendës.

Neni 26
Arbitraritete

1.Nëse palët e interesuara nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen në përputhje me atë që parashikon neni 25, ata përmes një marrëveshjeje të përbashkët mund t'ia paraqesin atë arbitraritetit, procedurë e cila jepet në apendiksin e kësaj Konvente. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, brenda 6 muajsh pasi është bërë kërkesa e parë për të hapur procedurat e pajtimit, mosmarrëveshja mund t'i paraqitet arbitraritetit me kërkesën e njërës prej palëve.

2. Secila nga palët në çdo kohë mund të deklarojë se ajo e njeh si të detyrueshëm, ipso facto dhe pa asnjë marrëveshje të veçantë për secilën nga palët e tjera, duke pranuar detyrime të njëjta, aplikimin e procedurave të arbitraritetit të dhëna në apendiksin e Konventës.

KREU X
MARRËVESHJE TË TJERA NDËRKOMBËTARE DHE LIGJI I BRENDSHËM I PALËVE

Neni 27
Marrëveshje të tjera ndërkombëtare dhe rregullime

1. Në marrëdhëniet e tyre dypalëshe palët që janë anëtarë të Komunitetit Ekonomik Europian do të aplikojnë ligjet e Komunitetit dhe kështu ata nuk do të aplikojnë rregullat që rrjedhin nga kjo Konventë jo si deri tani, pasi nuk ka pasur rregull komunitar që të drejtojë çështjen në fjalë.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk i ndalon palët nga arritja e marrëveshjeve ndërkombëtare, për të përmbushur apo zhvilluar dispozitat apo zgjerimin e fushës së tyre të aplikimit.

3. Në rast marrëveshjesh bilaterale kjo Konventë nuk do t'i alternojë të drejtat dhe detyrimet e palëve që lindin nga marrëveshje të tilla dhe të cilat nuk ndikojnë në plotësimin e të drejtave të palëve të tjera ose kryerjen e detyrimeve nën këtë Konventë.

Neni 28
Marrëdhëniet mes Konventës dhe të drejtave të brendshme të palëve

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk do t'i ndalojë palët të aplikojnë rregulla më strikte dhe më të detajuara se sa ato të parashikuara në Konventën aktuale për të programuar shërbime të

transmetuara nga grupe apo mjete teknike brenda juridiksionit të tyre të paraqitura në nenin 3.

KREU XI
DISPOZITA FINALE

Neni 29
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për t'u nënshkruar nga vendet anëtare të KE-së dhe vende të tjera anëtare të Konventës Kulturore Europiane, si dhe nga Komuniteti Ekonomik Europian. Ky është subjekti i ratifikimeve, pranimeve apo aprovimeve. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të periudhës tremujore pas datës kur 7 shtete, nga të cilët së paku 5 anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu bashkuar Konventës në përputhje me dispozitat e paragrafit paraardhës.

3. Një shtet mundet që në kohën e nënshkrimit apo në një kohë më të vonë por përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente mund të deklarojë se do të aplikojë Konventën në mënyrë provizore.

4. Në përputhje me shtetet e referuara në paragrafin 1 ose Komunitetit Ekonomik Europian, të cilët në të njëjtën kohë shprehin pëlqimin e tyre për t'iu bashkëngjitur Konventës, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasues të mbarimit të periudhës tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit dhe aprovimit.

Neni 30
Aderimi nga vendet joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimeve me shtetet kontraktuese mund të ftojë çdo shtet tjetër për të aderuar në këtë Konventë në saje të një vendimi të marrë nga mazhoranca paraqitur në nenin 20, pika d të Statutit të Këshillit të Europës dhe nga vota anonime e përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të zgjedhura për të marrë pjesë në Komitet.

2. Për të gjitha shtetet aderimi do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasues të periudhës tremujore të skadimit pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 31
Territori i aplikimit

1. Çdo shtet mundet që, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit, të specifikojë territorin ose territoret në të cilat kjo Konventë do të aplikohet.

2. Çdo shtet mundet që, në çdo kohë të mëvonshme, përmes një deklarate të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, të zgjerojë aplikimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Për çdo territor të tillë Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit pasues të përfundimit të periudhës tremujore pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë e përshkruar në dy paragrafet e mësipërme mundet që, në përputhje me territoret respektive të specifikuara në këto deklarata, të tërhiqet përmes një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të bëhet efektive ditën e parë të muajit pasues të përfundimit të periudhës 6-mujore pas marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 32
Rezerva

1.Në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij për ratifikim, pranim, aprovim ose aderim,

a. Çdo shtet mund të deklarojë se ruan të drejtën të kufizojë transmetimet në territorin e tij, në të vetmin rast kur ajo është në kundërshtim me legjislacionin kombëtar për shërbimet programore që përmbajnë reklama për pije alkoolike sipas rregullave të parashikuara për këtë rast në nenin 15 paragrafi 2 të kësaj Konvente.

b. Mbretëria e Bashkuar mund të deklarojë se ruan të drejtën për të mos përmbushur detyrimet, parashikuar në nenin 15 paragrafi 1, të ndalojë reklamën për produkte duhani, në lidhje me publicitetin për cigaret dhe duhanin për llulla të shpërndara nga Autoritetet e Pavarura të Huaja në territorin britanik me mënyra tokësore. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Një rezervë e formuluar sipas paragrafit të mësipërm nuk mund të përbëjë objekt kundërshtimesh.

3. Çdo shtet kontraktues që mund të ketë paraqitur një rezervë në kuadrin e paragrafit 1 mundet ta tërheqë atë plotësisht ose pjesërisht duke dërguar një njoftim te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Tërheqja do të bëhet e vlefshme në ditën që Sekretari i Përgjithshëm të marrë njoftim.

4. Një palë që ka formuluar një rezervë me subjekt një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një palë tjetër; ndërkohë që, nëse rezerva e saj është e pjesshme ose e kushtëzuar, mundet që të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite në të njëjtën mënyrë siç e ka pranuar ajo vetë.

Neni 33
Denoncimi

1. Çdo palë mundet, në çdo kohë, të denoncojë këtë Konventë duke i dërguar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë bëhet efektiv ditën e parë të muajit që vjen pas mbarimit të periudhës 6-mujore pas datës që Sekretari i Përgjithshëm ka marrë njoftim.

Neni 34
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit ose vendet e tjera që bëjnë pjesënë Konventën Kulturore Europiane, Komunitetin Ekonomiko-europian dhe të gjitha vendet, qofshin aderuese ose qofshin të ftuara për të aderuar në këtë Konventë për :

a. Çdo nënshkrim.

b. Depozitim i çdo instrumenti për ratifikim, pranim, aprovim ose aderim

c. Çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje m dispozitën në nenet 29, 30, 31.

d. Çdo raport të vendosur në përputhje me dispozitat në nenin 22.

e. Çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim apo komunikim që lidhet me këtë Konventë.

APENDIKS - Arbitrariteti

1. Kërkesa për arbitraritet do t'i bëhet e njohur Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Ajo do të përfshijë emrin e palës kundërshtuese dhe objektin e kundërshtimit. Sekretari i

Përgjithshëm do t'ia komunikojë informacionin e marrë të gjitha palëve të Konventës.

2. Në raste mosmarrëveshjesh mes dy palëve, kur njëra është shtet anëtar i Komunitetit Ekonomik Europian dhe tjetra duke qënë palë, kërkesa për arbitrim do t'i adresohet si vendit anëtar dhe Komunitetit të cilët në mënyrë të përbashkët do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm një muaj pasi kanë marrë kërkesën, nëse vendi anëtar ose Komuniteti, ose vendi anëtar dhe Komuniteti i përbashkët do të jenë palë e diskutimit. Në mungesë të një njoftimi të tillë brenda kohës së caktuar, vendi anëtar dhe Komuniteti do të konsiderohen si palë e vetme e çështjes, për shkak të aplikimit të dispozitave që rregullojnë konstitucionin dhe procedurat e gjykimit arbitrar. E njëjta gjë zbatohet kur vendi anëtar dhe Komuniteti në mënyrë të përbashkët paraqiten si palë në mosmarrëveshje. Në çështjet e parashikuara nga ky paragraf koha e parashikuar si një muaj në fjalinë e parë të paragrafit 4 që këtej e tutje do të zgjerohet në 2 muaj.

3. Gjyqi i arbitraritetit do të përbëhet nga tre anëtarë; secila nga palët e mosmarrëveshjes do të zgjedhi një arbitër; të dy arbitrat e zgjedhur do të përcaktojnë arbitrin e tretë sipas një marrëveshjeje të përbashkët, i cili do të jetë kryetari i gjykimit. Ky i fundit nuk do të jetë i të njëjtës kombësi me secilën nga palët që kanë mosmarrëveshje apo të ketë vendbanimin e zakonshëm në territorin e secilës nga palët apo të jetë i punësuar nga secili prej tyre apo të jetë marrë me çështje nën një titull tjetër.

4. Nëse njëri nga palët nuk ka zgjedhur një arbitër brenda një muaji pasi është komunikuar kërkesa nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, ai do të zgjidhet me kërkesën e palës tjetër nga presidenti i Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut brenda një periudhe tjetër njëmujore. Nëse presidenti i gjyqit nuk ka mundësi të veprojë ose është i të njëjtës kombësi me njërën nga palët në mosmarrëveshje, zgjidhet nënpresidenti i gjyqit ose gjyqtari më i moshuar në gjyq dhe jo i të njëjtës kombësie me secilën nga palët. Të njëjtat porcedura do të zbatohen nëse brenda një periudhe njëmujore pas zgjedhjes së arbitrit të dytë kryetari i gjyqit të arbitrimit nuk është përcaktuar.

5. Dispozitat e paragrafit 4 aplikohen vetëm në rastet kur duhet të mbushet një boshllëk.

6. Dy ose më shumë palë që vendosin nëpërmjet marrëveshjes se kanë të njëjtin interes, do të zgjidhin një arbitër të përbashkët.

7. Palët e mosmarrëveshjes dhe Komiteti do t'i sigurojnë gjyqit të arbitrazhit të gjitha lehtësitë e nevojshme për kryerjen efektive të procedurave.

8. Gjyqi i arbitrazhit do të përcaktojë vetë rregullat e procedurës. Vendimi i tij do të merret me shumicën e votave të anëtarëve të tij.Vlerësimi i tij do të jetë final dhe i detyrueshëm.

9. Vlerësimi i gjyqit të arbitrazhit do t'i bëhet i njohur Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do t'ua komunikojë atë të gjitha palëve të Konventës.

10. Secila palë në mosmarrëveshje do të përballojë shpenzimet e arbitrit të zgjedhur prej tij, këto palë do të ndajnë barabar shpenzimet e arbitrit tjetër, si edhe kosto të tjera të përcaktuara nga arbitrimi.